



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.06.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e punës së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2017”. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Florjon Mima, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Andrea Marto, Tatjana Pirro (Nurçe), Ilir Ndraxhi, Endri Hasa, Lorenc Luka, Hekuran Hoxhalli, Rakip Suli, Gjetan Gjetani, Izmira Ulqinaku, Eglandina Gjermani, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka, Vullnet Sinaj dhe Edmond Panariti.

Mungojnë:

Lefter Koka dhe Agron Çela.

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Të nderuar deputetë,

Në vijim të axhendës së kësaj jave, me të cilën besoj se jeni njohur të gjithë për ditën e sotme, kemi lënë për diskutim projektrezolutën e AKEP-it, ndërkohë që po bëjmë gati edhe propozimin *roam like home*, për të cilin besoj se jeni në dijeni. Bëhet fjalë për heqjen e tarifave *roaming* me Kosovën dhe jo vetëm.

Më duhet ta informoj komisionin që, pas një takimi që patëm me disa kolegë deputetë të parlamentit të Kosovës, u informuam se në parlamentin e tyre është depozituar një projektrezolutë, ndërkohë që ne kemi bërë gati draftin.

Unë do të ftoja cilindo nga deputetët që t'i bashkohet nismës sonë për t'i propozuar parlamentit shqiptar heqjen e tarifave *roaming* me Kosovën dhe jo vetëm me të.

Ju ndoshta jeni në dijeni, por për ato që nuk janë në dijeni, Shqipëria së bashku me Kosovën kanë aplikuar për t'iu bashkëngjitur një marrëveshjeje rajonale për reduktimin apo zerimin e tarifave *roaming* për të gjithë rajonin.

Kemi diskutuar nga pikëpamja teknike, ndërkohë që, sigurisht, propozimin do ta ndjekin edhe një sërë konsultash me kompanitë celulare, me AKEP-in, pra me të gjithë aktorët e përfshirë, sepse është një iniciativë që duhet përqafuar nga të gjithë. Besoj se javën tjetër do ta kemi gati draftin. Cilido prej kolegëve që do të dojë t'i bashkëngjitet kësaj ftese mund të kontaktojë me sekretarinë e komisionit, por besojmë se ka ardhur koha, madje jemi të vonuar lidhur me *roam like home* me Kosovën.

Në fakt, gjatë gjithë kësaj kohe kemi diskutuar projektrezoluta për disa institucione të pavarura, por kemi bërë edhe vizita pranë tyre, kemi diskutuar me titullarët e tyre për të njohur problematikat dhe nevojat që kanë.

Sot kemi shqyrtimin e projektrezolutës së AKEP-it, e draftuar që prej një muaji, ndërkohë që, për shkak të disa komenteve që na kanë ardhur në adresën, në *e-mail*-in e komisionit pas njoftimeve publike, por edhe disa shqetësime që kanë pasur kolegët e parlamentit. Sot kemi një draft të mirëmenduar dhe të mbështetur, sipas raportimeve që na bëjnë edhe shërbimet e Kuvendit, të sugjerimet, komentet apo vërejtjet, që i janë bërë draftit fillestar. Besoj se ky është një draft i mirë. Për hir të së vërtetës, ka pasur vërejtje për disa pika të veçanta (se çfarë duhet të heqim dhe se çfarë duhet të vendosim).

Ne besojmë fort dhe këtu dua të ripërsëris edhe një herë iniciativën e legjislaturës së kaluar, të cilën unë do ta gjykoja fantastike, ku një deputet i PS-së, një deputet i PD-së dhe

një deputet i LSI-së, firmosën një propozim pikërisht për të fuqizuar nga pikëpamja financiare, autoritetet e pavarura.

Ai propozim nuk është sot në kalendarin e Kuvendit. Unë besoj se duhet riaktivizuar kjo iniciativë. Sa më të forta të jenë institucionet e pavarura, aq më mirë do të funksionojë edhe tregu. Ne e kemi parë këtë me AKEP-in, me ERRU-në dhe me ERE-n. Ky është një moment për të reflektuar mbi atë që nuk është bërë, por që mund të bëhet. Jo rastësisht propozimi ka ardhur i iniciuar nga 3 përfaqësues të 3 partive të ndryshme. Kjo është bërë për të treguar pikërisht rëndësinë e institucioneve të pavarura. Kemi nevojë për tregje kompetitive dhe për tregje, ku të dominojë profesionizmi.

Që të gjithë i keni përpara materialet.

Në fillim, u uroj mirëseardhjen në komision disa deputetëve të PD-së! Të them të drejtën, e kam thënë që në këtë komision dhe nuk e kam as për shaka, as për hipokrizi se kontributi i opozitës ka qenë i qenësishëm, të paktën prej sa kohësh unë e drejtoj. Kam çmuar debatet civile që janë bërë, ku kemi qenë qytetarë edhe kur nuk kemi rënë dakord. Kemi marrë iniciativa të përbashkëta dhe janë marrë në konsideratë gjëra që bënin sens dhe sigurisht, kjo nuk është vetëm merita jonë, por është meritë e të gjitha forcave politike që kanë qenë në këtë komision.

Meqenëse shoh për herë të parë disa kolegë, i inkurajoj, duke u thënë se janë më shumë se të mirëpritur në komision për çështje të rëndësishme.

Këtu nuk ka të paktën deri tani, histori nga ato që një pjesë jona nuk do t'i shohë të përsëriten.

Pra, kur nuk biem dakord, nuk biem dakord, por kulturën e komunikimit dhe qytetarinë, e kemi ruajtur. Prandaj ju uroj mirëseardhjen në komision dhe ju thashë se dyert i kanë të hapura jo vetëm për këtë temë.

Sot kishim *roam like home* me Kosovën. Nesër mund të kemi çështje të rëndësishme. Unë vetë kam marrë pjesë në komisione të tjera për çështje për të cilat e kam parë të arsyeshme. Do të mirëpresim cilindo që për çështje të veçanta, ka diçka për të thënë.

Sot në rend të ditës kemi rezolutën për AKEP-in. Kemi 1 muaj që po diskutojmë për të. E kuptoj faktin që ju nuk keni qenë në komision, por ne sot kemi parashikuar ta miratojmë atë. Nëse ju gjykoni, që do të duhet ta shikoni...

Ju ka ardhur *me e-mail*. Nëse ju duhet kohë për ta parë rezolutën ...

Janë dokumente shumë të rëndësishme mbi të cilat ne gjykojmë punën e autoriteteve për vitin që vjen. Çdo nen është qëmtuar me kujdes për të mbajtur përgjegjësis dhe për të kërkuar llogari ndaj këtyre institucioneve.

Sot, ne kemi rënë dakord që t'ia propozojmë seancës parlamentare për ta miratuar. Ky është funksioni i Kuvendit. Gjithsesi, në rast se ju do të gjykoni që duhet kohë, mund ta shtyjmë edhe me një javë.

Ka diskutime?

Po, zoti Mima.

Florion Mima – Ju faleminderit!

Zoti Shalsi, për t'ju sqaruar më mirë, prezenca e shtuar e deputetëve sot, nuk ka të bëjë me faktin e diskutimit të *roam like home*, por për disa çështje që ne gjykojmë se janë disa herë, shumë herë, mijëra herë më të rëndësishme sesa *roam like home* dhe që opozita për gati në një vit punë të këtij sesi jua ka vënë vazhdimisht në dukje, ju ka paralajmëruar, ju ka dhënë rrugët e zgjidhjes për problemet madhore me të cilat ndeshet vendi në rrugëtimin e vet drejt Bashkimit Europian.

Ju patëm lajmëruar dhe thënë që me këtë mënyrë qeverisjeje do të jetë e pamundur të bindni strukturat e Bashkimit Europian për caktimin e një date dhe fillimin e negociatave, por u tallët dhe ironizuat deri në sarkazëm dhe grotesk edhe sot, dy ditë para konkluzionit. Fatkeqësisht, koha na dha të drejtë.

Gjasat janë që negociatat nuk do të hapen dhe nuk do të ketë një datë, por edhe nëse ka do ta ketë me kushte disa herë më të forta se kushtet e dhëna në herët e mëparshme.

Të gjitha këto na bëjnë që të ulemi dhe të reflektojmë për rrugën qorre që maxhoranca aktuale e ka futur vendin dhe perspektivën totalisht të mbyllur dhe të errët të anëtarësimit.

Para disa ditësh, të gjithë ne, opozita dhe maxhoranca, jemi njohur me një rezolutë të forcave politike qeverisëse në Gjermani, një rezolutë e dhimbshme, e cila skanon të gjitha problematikat e qeverisjes së Rilindjes, sidomos në mandatin e dytë dhe e vënë pikën mbi disa i, (nëntë për të qenë i saktë), të cilat janë sëmundjet, që po bëhen të pashërueshme, të këtij vendi, duke filluar me drogën, krimin, korrupsionin, duke vazhduar e reformën në drejtësi e cila po rezulton një reformë vetëm në letër, pasi vetëm një grusht fare i vogël gjyqtarësh dhe prokurorësh janë kaluar në sitën e verifikimit, duke vazhduar me mungesën e institucioneve eprorë të sistemit gjyqësor, me Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e

Lartë, me trupat e pamaterializuar në realitet me SPAK-un dhe me Byronë Kombëtare të Hetimit, e kështu me radhë. Për të gjitha këto ne ju patëm paralajmëruar, por ndeshëm në shurdhërinë tuaj, në memecërinë tuaj dhe ja ku jemi sot. Perëndimi po na e thotë të zezë mbi të bardhë se nuk jemi gati, sepse nuk mund të shkohet në Europë me një ministër të Brendshëm, i cili mbrohet nga hetimi në mënyrë politike, nga forca juaj politike, apo me një ministër tjetër të Brendshëm, vëllai i të cilit është i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykatat e vendeve anëtare të BE-së. Nuk mund të shkohet në Europë kur numri dy i partisë suaj akuzohet nga kreu i opozitës se është pritësi i një Toyota dhe fatkeqësisht rezulton që lideri i opozitës ka të drejtë. Dy ditë më pas pamë që Toyota ishte me *trademark*-ën e përshkruar dhe me sasinë e parave të fshehura në të. Ju vazhdoni të qeshni, por ky është një cikël i mirëmenduar nga ana juaj, që filloi me kanabizimin e vendit, vazhdoi me përfshirjen e vendit në listën e vendeve kryesore për trafikimin e kokainës dhe heroinës në Europë, që vazhdon aktualisht me hapin e katërt, që është shpërlarja e parave të pista që vijnë nga këto aktivitete nëpërmjet një aktiviteti kryesor, që është ndërtimi. Opozita ju ka thënë me kohë që bumi i lejeve të ndërtimit me 300% në këtë periudhë kohe, nuk është gjë tjetër veçse materializimi i një plani mafioz për të shpërlarë të gjitha këto para në një sasi tmerrësisht të madhe sa tronditini edhe parametrat monetarë dhe fiskalë të vendit.

Të gjitha ua ka thënë opozita, ju ka thënë edhe për PPP-të e pafundme e pafundme që po jepni dhe që janë në kundërshtim me praktikat më të mira botërore dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Jua ka thënë edhe FMN-ja, “Ndalojini” ju ka thënë. Ju jo vetëm që nuk po i ndaloni, por çdo ditë po vazhdoni të zhyteni në batakun e borxheve thjesht të pakontabilizuara. Por bijat dhe bijtë e këtij vendi do të vijnë dikur nëpër zyrat e këtij shteti dhe gjëja e parë që do të bëjnë është të kontabilizojnë detyrimet. Me këto kontabilizime të reja borxhi shkon në 84%. Pse shqetësohet opozita? Sepse në kuadrin e planit tuaj, për shpërlarjen masive të parave të pista, i keni drejtuar sytë edhe te qendra me tradicionale e Tiranës. Nuk është puna tek Teatri Kombëtar, se ju nuk doni t’ia dini fare, Teatri Kombëtar është rastësi që ndodhet aty. Aty mund të ishte cilido institucion tjetër i shtetit dhe ju do të rrekeshit të mbronit tezën tuaj se është ndërtesë e papërshtatshme, duhet shembur, duhet ndërtuar nga e para, se është rastësi që teatri është atje. Ky plan ka 20 vjet që vizatohet në mendjen e një njeriu, ai është shprehur që para 20 vjetësh se është një ngrehinë fashiste, e panevojshme, që është e denjë vetëm për të varur, kërkoj ndjesë për shprehjen: brekët e Violeta Manushit. Sot po e shikojmë se ku erdhëm. E gjithë ajo llokmë e Tiranës t’u jepet në dorë oligarkëve të lidhur me partinë, haptazi, të atyre oligarkëve që pasi bëjnë punime shkel

e shko miliona euroshe arrijnë të përmbysin edhe të vetmin institucion që duhej të kujdesej për rruajtjen e librave: Bibliotekën Kombëtare, që sot ka varur librat nëpër tela.

Zoti Shalsi, pse nuk hapni diskutimin? Jeni kryetar i komisionit që mbulon pjesën më të madhe të aktiviteteve prodhuese? Si mund të preket bulevardi kombëtar dhe e gjithë struktura me vlera historike? Janë tri ndërtesa në këtë aks me vlera historike, të cilat e kanë shëmtuar bulevardin origjinal dhe nuk hapet goja. Pse? Piramida, Pallati i Kulturës dhe Muzeu Kombëtar janë ndërtuar gjatë diktuarës komuniste, është herezi të të shkojë mendja që të kthehet bulevardi kombëtar në pjesën e tij në funksionet e veta siç u dizenjua 70 vjet më parë. Ju nuk guxoni, nuk keni kurajë.

Për të gjitha këto jemi të shqetësuar dhe kjo është arsyeja që sot kemi edhe prezencë, të ftuar anëtarë të nderuar të komisioneve të tjera. Unë besoj se secili nga anëtarët e opozitës duhet të marrë kohën e tij dhe të shprehet jo për *“Romë like home”* ...

Eduard Shalsi – *“Romë like home”* Pra, të flasësh midis dy vendeve njëlloj sikur je duke folur brenda një vendi.

Florjon Mima- Po, pra, por nuk jemi në leksion anglishteje këtu...

Eduard Shalsi- Zoti Mima nuk ka problem të mos dish diçka. Problemi është të mos e dish dhe të bësh sikur e di. Nuk e thashë me tendencë, sepse edhe unë vonë e kam mësuar.

Florjon Mima – Nuk e kam me ty, e kam me këtë që po them, nuk jemi këtu për *“Romë like home”*, por jemi për hallet e stërmëdha të këtij vendi, që po bëhen të tilla falë qeverisjes suaj. Dakord? Unë edhe një herë ju kërkoj që t’i jepni fjalën çdo deputeti që dëshiron ta marrë atë.

Eduard Shalsi - Faleminderit, zoti Mima!

Në vitin 2009, fatmirësisht e fillova si deputet në opozitë dhe kam qenë nënkryetar i komisionit, pikërisht në atë vend ku jeni ju sot. Për vitet 2009-2013 ka një ditar të komisionit, ka debate të regjistruara, ka edhe debate shumë të ashpra të regjistruara edhe me kamera. Ka qenë një periudhë shumë e vlefshme për mua personalisht për të reflektuar, se ndoshta nuk do të mund ta menaxhoja këtë komision, siç po bëj këto vite nëse nuk do të kisha kaluar atë eksperiencë.

Ju, zoti Mima e dini, por për të tjerët që vijnë për herë të parë në këtë komision, jo vetëm që nuk është raportuar ndonjëherë nga një ministër, arroganca që uleshin ta ajo karrigia atje, në një kohë që ne kemi nxjerrë përjashta titullarë që u janë drejtuar në mënyrë të pahijshme anëtarit të opozitës përgjatë 4 vjetëve. E keni të regjistruar në vitin 2012 se si janë përgjigjur kur kemi folur për hashashin e Lazaratit. E di se cili ka qenë ndryshimi?

Ndryshimi ka qenë pikërisht egërsia me të cilën opozita nuk të linte të flije në atë kohë, ne jemi dëshmitarë, sepse një pjesë jona kanë qenë dhe janë akoma këtu dhe ato gjëra që kanë ndodhur gjatë viteve 2009 - 2013, t@ them të drejtën i kemi reflektuar për të mos i bërë me ju, siç i bëtë ju me ne, pra kanë qenë leksione. Unë besoj që duhet të kalojmë në një nivel tjetër, nuk kam absolutisht asnjë problem, madje të jap të drejtë. Nëse duhet të ngresh çështje të tilla që i përkasin këtij komisioni, mund ta bësh lirshëm, me debat, pra jemi krejtësisht të hapur dhe nuk kemi asnjë frikë që ta shndërrojmë këtë komision në një arenë përplasjesh opinionesh dhe debatesh edhe kur nuk biem dakord, si për bulevardin, si për teatrin edhe për të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem mos më ndërpre, unë të respektoj dhe të kam respektuar edhe kur nuk kemi rënë dakord, që të ruaj krenarinë, prandaj të lutem mos më ndërpre. Në këtë komision ne kemi zhvilluar debate shumë të ashpra dhe nuk kemi rënë dakord, por këto nuk na pengon njeri t'i bëjmë përsëri. Jeni të ftuar të vizitat që komisioni bën, sepse ju e dini shumë mirë që ky komision nuk mblidhet vetëm këtu, por edhe në terren. Ky komision shkon edhe në institucione dhe u kërkon llogari institucioneve të ndryshme. Shkuam dhe pamë një vepër të madhe. Doni të ftojme arkitektët dhe kundërshtarët e teatrit? I ftojme, por ama ka një rregullore e cila thotë: të bëhet një kërkesë sot, për ju mund të mos jetë e rëndësishme, por të siguroj zoti Mima, se *Room Like Home* me Kosovën ishte një shqetësim i deputetëve kosovarë dhe është një shqetësim imi dhe duam t'i shohim të dyja vendet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem tani, ja filluat përsëri.

Kur drejton komisionin, kam thënë bëj si të duash, por në këtë mjedis, të lutem shumë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kur gren dorën, ia jap fjalën dhe flet 5 minuta.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të nderuar kolegë, kjo është draftrezoluta. Nëse keni diçka...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo nuk votohet, ne thjesht ia kalojmë seancës. Meqenëse kolegët e opozitës po njihen sot me projektrezolutën, sepse ne kemi një muaj që po e diskutojmë, në do të sugjeroja ta shtyjme për javën tjetër...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani t'i japim një mundësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë t'ia propozojmë seancës?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Faleminderit dhe jeni më shumë sesa të mirëpritur për të diskutuar çështje të veçanta.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA